

Udhezues per etiketen GS1-128 te paletave:

Sigurohuni qe klientet te jene te kenaqur me etiketen GS1-128 te paletes

Etiketa GS1-128 per paletat perdoret ne njesite logjistike, ose me fjale te tjera ne ato njesi qe transportohen, zakonisht kutite qe transportohen individualisht apo paletat. Per te mos patur problem ne zinzhirin e furnizimit, duhet te aplikohen standarte per transferimin e

Informacionit nga te gjitha palet, ne menyre qe te dekodohet vazhdimisht informacioni qe gjendet ne etikete. Ky udhezues perben nje liste per te krijuar ne menyre korrekte etiketat GS1-128.

Kjo pjese e etiketes perdoret zakonisht per **logon** e kompanise tuaj dhe **pershkrimin** e produktit.

Kjo pjese e etiketes duhet te tregojte **te gjitha** te dhenat qe gjenden ne barkod ne tekst te lexueshem nga njerezit, p.sh. numri GTIN, data e perdorimit, numri i lotit dhe SSCC (numri serial unik i paletes).

AI (02) tregon qe 14 shifrat ne vazhdim paraqesin GTIN-ne e permbajtjes se paletes, me fjale te tjera numrin GTIN te kutise (zakonisht njesia e porositur).

- **(02) nuk mund te ndiqet nga GTIN-ja e paletes apo njesise se tregtuar**
- (02) duhet te ndiqet gjithnje nga nje GTIN 14 shifror. Nese numri i artikullit ka 13 shifra, i shtohet nje 0 prefiksit.
- Kur perdoret (02), numri i kutive ne palete duhet te specifikohet gjithnje pas AI (37).

Çfare eshte nje AI?

Nje Identifikues i Aplikimit (AI) eshte nje numer i perbere nga 2-4 shifra. Ai i tregon programit "mbrapa" skanerit te barkodit formatin dhe kuptimin e shifrave dhe/ose shkronjave te vendosura pas AI-se.

Fabrika sh.p.k
Autostrada Tirane-Durres, km. 2, Tirane

Bizele te ngrira - 48 kuti
6 paketime nga 500 grame

SSCC 35704368000000011	Cope 48
GTIN 5704368000010	Nr. i Lotit 12345XF
Data e Perdorimit 31.12.2018	



(15) 181231 (10) 12345XF



(02) 05704368000010 (37) 48



(00) 35704368000000011

AI (15) tregon qe shifrat ne vazhdim paraqesin **daten e perdorimit** te njesise se tregtuar.

- (15) duhet te ndiqet nga **6 shifra**, duke e filluar daten ne formatin VVMMDD.

AI (10) tregon qe shifrat ne vazhdim paraqesin **numrin e lotit**.

- (10) mund te kete deri ne **20 shifra** dhe/ose shkronja.
- Nese barkodi do te permbaje me teper te dhena pas numrit te lotit, duhet vendosur nje karakter ndares (**FNC1**) pas numrit te lotit.

AI (37) tregon qe shifrat ne vazhdim paraqesin **numrin e njesive qe ndodhen ne palete** – p.sh. numri i njesive me GTIN te treguar pas (02). Ne shumicen e rasteve kjo nenkupton **numrin e kutive** ne palete.

- (37) mund te kete deri ne **8 shifra**. Nese numri ka me pak se 8 shifra, **mos i shtoni zero perpara**.
- Nese barkodi do te permbaje me teper te dhena pas numrit te njesive, duhet vendosur nje karakter ndares (**FNC1**) pas numrit te njesive.

AI (00) tregon qe shifrat ne vazhdim paraqesin **Kodin Serial te Ngarkeses (SSCC)**: Numri unik serial i paletes.

- Nje kod SSCC **nuk mund te perdoret per disa paleta**, edhe nese paletat permbajne te njejtat produkte.
- Kodi SSCC duhet te vendoset ne barkodin e fundit, ne rast se ka disa barkode te perdorura.

Evitoni gabimet te etiketa e paletes: 13 veprime qe duhen apo nuk duhen bere



Probleme me permbajtjen e te dhenave ne etiketen e paletes

- (1) Lloji i barkodit duhet te jete **GS1-128**, i njohur me perpara si EAN128 apo UCC/EAN128. **Kode 128** eshte nje lloj tjetër barkodi, dhe nuk duhet te perdoret.
- (2) Nje karakter ndares (**FNC1**) duhet te vendoset gjithnje pas nje fushe te dhenash me gjatesi variabel, ne rast se kjo fushe te dhenash ndiqet nga me teper te dhena. Nese eshte e mundur, vendosni te dhenat variabel ne fund te barkodit.
- (3) **Kllapat** nuk duhet te shprehen ne barkod, por duhet te jene te dukshme ne tekstin poshte barkodit.
- (4) **Llogaritni Shifrat e Kontrollit** per kodet GTIN dhe SSCC ne menyre korrekte ne adresen: <http://www.gs1.org/check-digit-calculator>.
- (5) **AI (37)** mund te perdoret vetem se bashku me **AI (02)**.
- (6) Nese paleta eshte nje njesi, qe porositet, atehere **AI (01)** perdoret ne vend te **AI (02)** dhe **AI (37)**.
- (7) **Çdo palete** duhet te identifikohet me nje kod unik 18 shifror te quajtur **SSCC**.
- (8) B arkodi nuk mund te permbaje informacion te brendshem te kompanise ne formen e **AI (91)-(99)**. **AI (90)** mund te perdoret vetem ne marreveshje me klientin. Per nje liste me te detajuar te Identifikuesve te Aplikimit (**AI**) vizitoni kapitullin 3.2 te Specifikimeve te Pergjithshme **GS1** ne adresen: http://www.gs1.org/docs/barcodes/GS1_General_Specifications.pdf.

Probleme me vendosjen e etiketes se paletes, paraqitjen, etj.

- (9) Nje zone e **dedikuar** bosh (e quajtur ndryshe “zone e qete”) duhet te gjendet ne te majte dhe ne te djathte te barkodit. .
- (10) Shufrat e erreta te barkodit duhet te jene te qarta ne nje sfond te lehte (zakonisht me ngjyre te bardhe).
- (11) Vendoseni etiketen e paletes ne nje siperfaqe **te lemuar** dhe pa rrudha.
- (12) Madhesia e rekomanduar e etiketes se paletes eshte **A5**.
- (13) Etiketa **GS1-128** e paletes duhet te vendoset ne palete ne menyren e treguar meposhte. Etiketa identike **duhet te vendosen ne te dyja anet** e paletes. Nje per çdo ane.

Distanca nga cepi i paletes me etiketen:
Min. 50 mm.

